



# Kristaq Gjurgjaj

Kryeauditues

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Z. Kristaq Gjurgjaj ka kryer studimet e larta në periudhën në periudhë 1988 – 1992, pranë Fakultetit Ekonomik, Dega Ekonomist për Industrinë, UT- Tiranë. Gjithashtu, ka kryer studimet në nivelin e dytë “Master i Shkencave në Financë”, Universiteti Kristal, si dhe kurse kualifikimi profesional “Standartet Kombëtare të Kontabilitetit” (SH.K.F.SH) dhe “Kontabël i Miratuar”.

Ka një eksperiencë të gjatë në administratën publike, përkatësisht për vitet 1992 – 2006 si kontrollor në Degën e Tatim Taksave Mat, në pozicionet nga kontrollor deri në Kryetar të Degës së Tatimeve Mat (periudha 1993 – 1997).


Në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka filluar punë që nga viti 2006 e në vazhdim, duke pasur disa funksione, fillimisht si auditues në Departamentin e Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit (në pozicionin nga e Audituesit i I-rë deri në Kryeauditues), në Departamentin e Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtorinë e Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit (në pozicionin si Audituesit të Lartë). Gjatë kësaj periudhe në kohë të ndryshme ka kryer për një periudhë 3 dhe 6 mujore, detyrën e Drejtorit të komanduar në Departamentin e Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit dhe Departamentin e Vetëqeverisjes Vendore.


Aktualisht Z. Gjurgjaj mban pozicionin e “Kryeaudituesit” në Departamentin e Auditimit të Institucioneve të Sigurisë, Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

Gjatë kësaj eksperience të gjatë profesionale, Z. Gjurgjaj ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh/konferencash/workshop-e brenda dhe jashtë vendit në lidhje me çështjet e auditimit të jashtëm në sektorin publik, si në: Turqi, Poloni, Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Letoni, etj. Gjithashtu ka bërë dhe disa publikime në median e shkruar lidhur me financat vendore, kontrollin e institucioneve publike, si dhe mbi prokurimet publike.

Z. Gjurgjaj ka njohuri mbi gjuhën Angleze.

## Kontakt

 [kgjurgjaj@klsh.org.al](mailto:kgjurgjaj@klsh.org.al)

 Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë  
Shqipëri

 [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)